



# Prodhimi Organik i Bimeve Aromatike dhe metodat e kultivimit 3( versioni i shkurter - pjesa 3)

(Resource ID: 364)

**Samantha Prior**

samantha.prior(at)ul.ie

This teaching resource is allocated to following University:

**UL - University of Limerick**

Institution:

**University of Limerick**

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/364.Prodhimi-Organik-i-Bimeve-Aromatike-dhe-metodat-e-kultivimit-3-versioni-i-shkurter-pjesa-3>



**Puna ne grup**



**Me shume  
sesa 30  
studente**



**Deri në 3 njësi  
leksionesh**



**Anglisht, Shqip**

"Prodhimi Organik i Bimeve Aromatike dhe metodat e kultivimit ( versioni i shkurter - pjesa 1,2,3) eshte nje set i burimeve te mesimdhenies bazuar ne kursin e simestrit 1 me te njejtin titull. Burimi origjinal u zhvillua qe te mesonte studentet per prodhimin e bimeve aromatike organike dhe praktikat me te mira ne koleksionin e eger te bimeve medicinale dhe aromatike ( MAPs). Do te perfshije gjithashtu edhe dy raste studimi dhe udhetim ne terren tek Sonnentor SHPK ne Shqiperi ose Agroprodukt SHPK ne Kosove; te dyja merren me eksportin e bimeve aromatike dhe medicinale organike. Metoda te tjera perfshijne Brainstorming, te mesuarin me

baze problemore dhe diskutimin. Seti pershkruan tre burime te pavarura te mesimdhenies te cilat jane dizenuar te plotesohen njera pas tjetres ( por jo domosdoshmerisht), dhe keto perfshijne: 1- Identifikimi bimeve medicinale dhe aromatike dhe zgjidhja e problemeve 2- Mesimdhenia me rast studimi - Sonnentor sh.p.k and Agroprodukt sh.p.k 3- Puna ne terren - Sonnentor sh.p.k and Agroprodukt sh.p.k Burimi origjinal i mesimdhenies u nda ne disa pjese per te bere me te sigurt prezantimin e metodave inovative te mesimdhenies ne pika te ndryshme ne leksione. Nuk eshte e nevojshme te plotesohen te gjitha pjeset.

### **3- Puna ne terren- Sonnentor shpk dhe Agroprodukt shpk**

Duke perdorur planin e biznesit te krijuar ne pjesen 2, studentet do te vizitojne ose Sonnentor shpk ose Agroprodukt shpk ( ose ndonje kompani medicinale ose aromatike tjeter) per te takuar fermeret ( palet e interesit). Ata do te vezhgojne metodat e kultivimit ne praktike dhe te intervistojne fermeret se perse ata i kane zgjedhur metodat e kultivimit qe nuk jane miqesore me natyren ose te qendrushme. Ne grupet e tyre nga pjesa 2, studentet do te prezantojne me pas planin e tyre te biznesit dhe idete per fermeret, dhe metoden e diskutimit qe do te perdorin per te diskutuar sfidat e jetes reale qe duhet te perballojne si dhe kufizimet e planeve te biznesit te rekomanduara nga studentet.

#### **Teksti kryesor:**

Aktivitetet e mbjelljes, kultivimit, procedimit dhe tregimit te bimeve aromatike dhe medicinale jane nje biznes i madh i bujqesise dhe pylltarise me potencial te madh per zhvillimin e qendrushem te zonave rurale ne Shqiperi. Ferma organike duket nje nga nen-sektoret me premtues me potencial te madh te fermereve dhe perpunuesve.

Shqiperia eshte nje nga burimet me te pasura dhe cilesore te botanikes, duke e kthyer edhe ne nje burim tashme te njohur furnizimi - 15% e saj , 3250 specie: medicinale, aromatike, ereza dhe tanin kane nje vlere te rendesishme. Kjo industri kontribuon ne 18% te eksporteve bujqesore. Pervec kesaj duke qene nje burim i madh per ekonomine, duke arritur perafersisht 20 milione euro ne vit ne 2013, ky sektor luan nje rol te rendesishem socio-ekonomik, duke kontribuar keshtu deri ne 35% te te ardhurave, sepse vleresohet se rreth 80.000 njerez jane perfshire si kultivues dhe mbledhes te tyre. Duke njohur rolin dhe potencialin e ketij nen-sektori, strategjia nder-sektorale per zhvillimin e bujqesise dhe zonave

rurale konsideron kete industri te rendesishme per diversifikimin rural dhe eshte nder sektoret prioritare qe mbeshtetet permes instrumentave te shumte e te ndryshem.

Shumica e Bizneseve te MAP perbehet nga produkte te egra. Megjithate, ka nje ngritje te koston se punes ne mbledhjen e ketyre bimeve per shkak te mbi popullimit te burimeve natyrore ne disa zona dhe mungeses se popullsise ne disa te tjera, duke rritur keshtu koston e prokurimit, konkurrimit midis shitesve me shumice dhe veshtiresive per te pershtatur potencialin e tregut vetem me produkte te egra, jane duke rritur interesin e operatoreve per kultivimin e disa prej ketyre bimeve, kryesisht atyre aromatike. Faktore te tjere, kryesisht perfitimi i larte dhe mbeshtetja e skemave mbeshtetese te qeverise kane rritur ne menyre drastike kultivimin ne vitet e fundit duke ofruar nje burim te konsiderueshem te te ardhurave per mijera banore. Siperfaqja e kultivimit eshte rritur nga 1877 ha ne 2001, ne 5000 ha ne 2013 prej te cilave 4000 ha jane mbjelle me sherebele dhe pjesa tjeter me bime te tjera si livando, etj.

Ka potencial per zgjerimin e tregut per shume bime te rritura ne menyre te eger por me e rendesishmja (per fermeret) per shume bime te tilla te kultivuara. Megjithate, kjo kerkon permiresimin e teknologjise se kultivimit, korrjes dhe pas-korrjes. Kultivimi organik duket se eshte nje nga nen sektoret me premtues me potencial te madh, si per fermeret, edhe per perpunuesit.

Bazuar ne nevojen per burime per rritjen e bimeve organike dhe praktika te mira bujqesore ne mbledhjen e bimeve medicinale, ky komponent synon te pergatiti burime te tilla te cilat jane te perdorshme per studentet, fermeret dhe operatoret. Keto metoda mesimdhënieje perfshijne Brainstorming, te mesuar me baze problemin, diskutimin dhe do te kombinohen me raste studimi dhe udhetime ne terren tek dy kompanite Sonnentor shpk ne Shqiperi dhe Agroprodukt shpk ne Kosove.

---

## Mjetet e mësimdhënies



Ekskursion ose field trip

## Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Sonnetor shpk ne Shqiperi dhe Agroprodukt shpk ne Kosove, te dyja te specializuara ne prodhimin ( edhe te kultivuar, edhe te mbledhjes ne gjendje te eger) te materialeve bruto organike. Ata do te perfshihen ne procesin e mesimdhenies si partnere aktive dhe studentet mund te jene ne kontakt direkt me rrjetin e fermerëve dhe mbledhesve ne gjendje te eger ne rajone te ndryshme ne Shqiperi dhe Kosove. Burimet e prodhuara mund te jene me perfitim per keta fermere dhe mbledhesit. Mbi te gjitha studentet mund te ofrojne ide biznesi nga fermeret dhe mbledhesit e zakonshem .

## Pika e forte

- Pervoje aktive e te mesuarit per studentet
- Te mesuar i perbashket per studentet, fermeret dhe palet e interesit te biznesit.
- Studentet mesojne te zhvillojne nje ide biznesi te qendrueshme ne bazen e ndermarrjeve ekzistuese aktive ne fushen e qendrueshmerise dhe siper marrjes sociale,
- Studentet mendojne per mundesite e tyre dhe pergjegjesine ne kontekstin e ndryshimit global.

## Pika e dobët

- Disa fermere mund te mos pelqejne te ndajne te gjitha praktikat e tyre te kultivimit ose mund te mos jene te hapur per ndryshim.

## Rezultatet e të mësuarit

- Te prezantoje planin e biznesit tek palet e interesit
- Te vleresoje rendesine e qendrueshmerise ne Industrise Bujqesore

## Lidhja për qëndrueshmëri

Mungesa e popullsisë ne zonat e brendshme rrezikon rrjetin e koleksionit ekzistues te bimeve te egra mjekesore dhe pengon qendrueshmerine e zixhirit te vleres.

- Bime te egra te demtuara rrezikojne si sektorin e qendrueshmerise dhe bio-diversitetin.
- Mbi te gjitha, shume fokus ne keto bime mund te shkaktoje nje mbi-furnizim. Rreziku eshte ne rritje edhe me perdorimin e nitrateve ne kultivimin e tyre.
- Keto burime te mesimdhenies permbajne praktika te mira te koleksionit per bimet e egra mjekesore dhe aromatike

- Zhvillimi i sektorit konkurrues dhe te koordinuar i orientuar drejt volumit ne rritje dhe produktet e vleres se shtuar te cilat mund te arrijne standartet e tregut dhe kerkesat per mbrojtjen e diversitetit biologjik dhe kontributin ne qendrushmerine sociale dhe ekonomike te familjeve rurale.

## **Njohuri paraprake**

Asnje lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

## **Përpjekjet e përgatitjes**

Mesatare

## **Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes**

Identifikimi dhe takimi me palet e interesit nga Sonnentor shpk dhe Agroprodukt shpk

## **Aksesi**

Free

## **Gjykimi / vlerësimi**

Prezantimi i planit te biznesit

## **Kreditim/Çertifikatë**

Kredit per krijimin dhe prezantimin e planit te biznesit

## **Financuar nga**

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.